
AKT THEMELIMI

"NEW GLOBAL INVESTMENT SOLUTION" SHPK

1. Forma ligjore dhe emri i shoqërisë

Emri i shoqërisë do të jetë **"NEW GLOBAL INVESTMENT SOLUTION" SHPK**, nga këtu e më poshtë referuar edhe si "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".

2. Ortaku i vetëm i shoqërisë është:

- **"KASTRATI AVIATION HOLDING" SHPK** me nr. NUIS M21612025K me seli në adresën: Njësia Bashkiake Nr.5, Zona Kadastrale 8160, Sheshi "Italia", Mak Albania Hotel, Tiranë, Shqipëri.

3. Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarisë do të jetë:

- Ofrimi i shërbimeve imobiliare, ndermjetësim, shit-blerje të pronave të paluajtshme, dhënie me qira/nën qira të pasurive të paluajtshme etj;
- Shoqëria do të kryejë aktivitetin e tregtimit me shumicë dhe pakicë, impianteve/paneleve fotovoltaike/eulike. Ofrimi i konsulencës dhe asistencës teknike për projektimin, studimin, mirëmbajtjen, mbikëqyrje, kolaudim, riparimin, prodhimin e pajisjeve elektrike, fotovoltaike, eulike dhe të çdo materiali tjetër ndihmës të sistemit dhe rrjetit elektrik. Import-eksport i materialeve, makinerive, pajisjeve dhe impianteve të ndryshme elektrike, elektroshtëpiake, elektronike, sistemeve/impianteve termike, sisteme për mirë-menaxhimin e energjisë, sisteme ndriçimi, të telekomunikacionit si dhe impianteve të tjera të ngjashme të destinuara për objekte civile dhe industriale.
- Shitja me shumicë dhe pakicë brenda dhe jashtë vendit të energjisë elektrike, dhe të materialeve të ndryshme elektrike/fotovoltaike e eulike dhe pajisjeve të tyre, duke përfshirë të gjitha elementet e impianteve të energjisë alternative.
- Shërbimet e shoqërisë konsistojnë por pa u kufizuar në ofrimin e konsulencës në fushën e marketingut nisur nga promovimi, reklamimi, shërbimi ndaj

klitentit, diferencimi, segmentimi, shitje direkte, marketing online, taktikat e marketingut, marrëdhëniet me publikun.

Shoqëria mund të kryejë çfarëdo veprimtarie tjetër që lejohet nga legjislacioni në fuqi i Republikës së Shqipërisë.

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet me vendimin e Asamblesë së ortakëve.

4. Selia e shoqërisë

- Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: **Godina e Administratës së Aeroportit Ndërkombëtar "Nënë Tereza", Rinas, Nikel, Shqipëri.**
- Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

5. Kohëzgjatja e shoqërisë

Afati i veprimtarisë së Shoqërisë është **i pacaktuar**. Ky afat fillon nga data e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

6. Kapitali themeltar

- Kapitali themeltar i shoqërisë është ALL 1,000,000 (një milion lekë).
- Kapitali përbëhet nga 1 (një) kuotë me vlerë nominale ALL 1,000,000 (një milion lekë) dhe zotërohet nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë.

7. Organet vendimmarrëse të shoqërisë

Organet vendimmarrëse të shoqërisë janë:

- Asambleja e Ortakëve.
- Administratori.

8. Administratori

- Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm. Administrator i parë i shoqërisë është: **Znj. Xhorxhia FERHATI, shtetase Shqiptare, e datëlindjes 12.02.1997, banuese në Tiranë, e**

identifikuar nga karta e identitetit me nr. 032766196 dhe nr. personal
J75212051U.

9. Likuidimi i shoqërisë

Në rast prishje të shoqërisë, likuidimi apo falimentimi, shoqëria do të likuidohet në përputhje me dispozitat në fuqi në legjislacionin shqiptar.

ORTAKU I VETËM

SHOQËRIA "KASTRATI AVIATION HOLDING" SHPK

Përfaqësuar nga: Zj. Eda Spahiu

Eda Spahiu



[emër, mbiemër, firmë, vulë] - **21.11.2022**